

LIGJ
Nr.9297, datë 21.10.2004

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9087, DATË 19.6.2003
“KODI ZGJEDHOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

(Ndryshuar me ligjin nr. 9371, datë 14.4.2005)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 81 pika 1 dhe 2 shkronja “d”, nenit 83 pika 1 dhe nenit 154 të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.9087, datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

Neni 1

Neni 26 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 26

Përtëritja e përbërjes dhe zëvendësimi i anëtarëve të KQZ-së

1. Përbërja e KQZ-së përtërihet çdo tre vjet dhe realizohet në dy faza, sipas modaliteteve dhe procedurave të parashikuara në nenin 22 të këtij Kodi.
2. Në fazën e parë përtërihen 4 anëtarë të KQZ-së:
 - a) një anëtar i zgjedhur nga Kuvendi;
 - b) një anëtar i zgjedhur nga Presidenti i Republikës;
 - c) dy anëtarë të zgjedhur nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë.
3. Në fazën e dytë përtërihen 3 anëtarë të KQZ-së:
 - a) një anëtar i zgjedhur nga Kuvendi;
 - b) një anëtar i zgjedhur nga Presidenti i Republikës;
 - c) një anëtar i zgjedhur nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë.
4. Anëtarët e rinj të KQZ-së zgjidhen jo më vonë se 30 ditë nga data e mbarimit të mandatit të anëtarëve që largohen.
5. Në rast të mbarimit të parakohshëm të mandatit të anëtarit të KQZ-së, sipas nenit 25 të këtij Kodi, organi që e ka zgjedhur anëtarin që largohet, emëron një anëtar zëvendësues brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të vakancës. Anëtari zëvendësues qëndron në detyrë deri në mbarimin e afatit të mandatit kushtetues dhe ligjor që gëzonte sipas aktit të zgjedhjes anëtari i larguar para kohe.
6. Pavarësisht nga pika 4 e këtij neni, përbërja e KQZ-së nuk mund të ndryshohet gjatë periudhës së zgjedhjeve. Në këtë rast, anëtarët ekzistues zëvendësohen brenda 30 ditëve nga përfundimi i periudhës së zgjedhjeve. Në rast se mandati i një anëtari të KQZ-së përfundon para kohe gjatë periudhës së zgjedhjeve, ai zëvendësohet nga organi përkatës sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se 48 orë nga krijimi i vakancës.”.

Neni 2

Pas nenit 181, shtohet neni 181/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 181/1

Përfundimi i mandatit të anëtarëve të KQZ-së në funksion të përtëritjes së përbërjes së tij

1. Mandati i anëtarëve të KQZ-së të parashikuar në nenin 26 pika 3 të këtij Kodi mbaron më 31 mars 2006. Mandati i anëtarëve të KQZ-së të parashikuar në nenin 26 pika 2 të këtij Kodi, mbaron më 31 mars 2010.

2. Anëtarit të KQZ-së, i cili është zgjedhur fillimisht nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe nuk është përfshirë në përtëritje, sipas pikave 1 dhe 2 të nenit 25 të ligjit nr.8609, datë 5.8.2000 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të shfuqizuar, i mbaron mandati në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji. Anëtari zëvendësues zgjidhet nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë në përputhje me nenin 22 pika 3 shkronja “a” të këtij Kodi.

3. Mandati i anëtarit të ri të KQZ-së, të zgjedhur në zbatim të pikës 2 të këtij neni, mbaron në të njëjtën ditë me atë të anëtarëve të tjerë të KQZ-së të parashikuar në nenin 26 pika 2 të këtij Kodi.”.

Neni 3

(Shfuqizuar me ligjin nr. 9371, datë 14.4.2005)

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4366, datë 25.10.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**